



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

RREGULLORE

**PËR
KOMISIONIN E NOMENKLATURËS DHE FUNKSIONIMIN E
SEKRETARIATIT TË TIJ**

Kjo rregullore hartohet në bazë të nenit 24 të Ligjit nr. 17/2018, “Për statistikat zyrtare”, Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe pikës 4 të VKM nr. 671, datë 7.11.2018 “Për ngritjen, funksionimin dhe detyrat e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën”.

**KREU I
TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Qëllimi i Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën

1. Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën, këtë e tutje “Komisioni” është organi, i cili ka për detyrë të kryejë përditësimin, përshtatjen dhe zbatimin e klasifikimeve statistikore, ekonomike dhe sociale, në përputhje me klasifikimet statistikore evropiane dhe ndërkombëtare.
2. Komisioni e ushtron aktivitetin e tij në përputhje me nenin 24 të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” dhe akteve nënligjore që rregullojnë ngritjen, funksionimin, detyrat dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të këtij komisioni.

Neni 2

Objekti i Rregullores së Komisionit

1. Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e rregullave më të detajuara për veprimtarinë e Komisionit në përputhje dhe zbatim të Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe VKM nr. 671, datë 7.11.2018 “Për ngritjen, funksionimin dhe detyrat e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën”.
2. Kjo rregullore përcakton rregullat për funksionimin e Sekretariatit të Komisionit, mbështetur në pikën 4 të VKM nr. 671, datë 7.11.2018.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Neni 3

Përkufizime

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- 1) “anëtar” nënkupton anëtarët e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën;
- 2) “Komisioni” nënkupton Komisionin Kombëtar për Nomenklaturën;
- 3) “Kryetari” nënkupton Kryetarin e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën;
- 4) “Nomenklaturë” nënkupton emërtimin sistematik të kategorive, dukurive ose sendeve për qëllime statistikore ;
- 5) “Sekretariati” nënkupton personat e caktuar të mbulojnë detyrën e Sekretariatit të Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën;

KREU II

ORGANIZIMI DHE KOMPETENCAT

Neni 4

Komisioni

1. Komisioni ushtron funksionet e veta në zbatim të:
 - a) legjislacionit për statistikat zyrtare;
 - b) legjislacionit për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike;
 - c) vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, i miratuar në mbështetje të pikës 4 të nenit 24 të Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”;
 - ç) vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave për miratimin e nomenklaturave;
 - d) vendimet dhe udhëzimet e Komisionit, si dhe kjo rregullore.
2. Institucionet e përfaqësuara në Komision përcaktohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.
3. Komisioni punon për përshtatjen dhe zbatimin e nomenklaturave në vend. Për ushtrimin e funksioneve të veta, Komisioni kryen këto detyra:
 - a) miraton rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Komisionit;
 - b) diskuton dhe vendos për zbërthimin e mëtejshëm të strukturës së nomenklaturave dhe, sipas rastit, për agregimin apo suprimimin e nënndarjeve të veta, në përputhje me situatën specifike të vendit dhe rregullat ndërkombëtare të ndërtimit të nomenklaturave;
 - c) i propozon Këshillit të Ministrave miratimin me vendim të veçantë të nomenklaturës së dakordësuar nga anëtarët e Komisionit, për tu zbatuar në Republikën e Shqipërisë;
 - ç) harton dhe miraton brenda tremujorit të parë të vitit planin vjetor të aktiviteteve të tij;

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

d) nxjerr udhëzime për zbatimin në praktikë të nomenklaturave nga institucionet publike;

dh) monitoron çdo 6 muaj zbatimin në praktikë të nomenklaturave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

e) kontribuon në hartimin e materialeve të trajnimit për stafet e institucioneve publike të cilat kanë në përgjegjësi zbatimin e nomenklaturës;

e) zgjedh zëvendëskryetarin e Komisionit.

Neni 5
Strukturat

Strukturat e Komisionit janë:

- 1) Kryetari i Komisionit;
- 2) Zëvendëskryetari i Komisionit;
- 3) Anëtarët;
- 4) Sekretariati.

Neni 6
Kryetari i Komisionit

1. Kryetari i Komisionit është Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it për shkak të ligjit.
2. Kryetari ka këto kompetenca:
 - a) i propozon Komisionit kandidatin për zëvendëskryetar të Komisionit;
 - b) thërret dhe kryeson mbledhjen e Komisionit;
 - c) cakton vendin e mbledhjes dhe rendin e ditës;
 - ç) i përcjell anëtarëve të Komisionit, nëpërmjet Sekretariatit, dokumentacionin e mbledhjes;
 - d) nënshkruan shkresat përcjellëse që dalin nga Komisioni dhe procesverbalet e mbledhjes së tij;
 - dh) merr masa për publikimin e veprimtarisë së Komisionit në faqen zyrtare elektronike të INSTAT-it;
 - e) raporton veprimtarinë e Komisionit në Këshillin e Statistikave dhe Kuvendin e Shqipërisë.

Neni 7
Zëvendëskryetari i Komisionit

1. Zëvendëskryetari është anëtar i Komisionit dhe përfaqësues i njërit prej agjencive statistikore në Komision.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

2. Zëvendëskryetari i Komisionit ka këto kompetenca:

- a) kryeson mbledhjen në mungesë të Kryetarit;
- b) mbulon detyrat e deleguara nga Kryetari vetëm për çështje të organizimit të mbledhjes së Komisionit.
- c) jep mendim për vendin, rendin e ditës dhe dokumentacionin e mbledhjes, përpara nënshkrimit nga Kryetari.
- ç) nënshkruan procesverbalim e mbledhjes së Komisionit, nëse kjo mbledhje është drejtuar nga zëvendëskryetari.

Neni 8

Zgjedhja e Zëvendëskryetarit

- 1. Zëvendëskryetari zgjidhet në mbledhjen e parë Komisionit, pas miratimit të kësaj Rregulloreje.
- 2. Kandidati për Zëvendëskryetar propozohet nga Kryetari i Komisionit. Propozimi për kandidatin bëhet me shkrim, me nënshkrimin e Kryetarit dhe dorëzohet pranë Sekretariatit të Komisionit. Shkresa e propozimit duhet të përmbajë emrin e kandidatit dhe arsyetimin e propozimit.
- 3. Zëvendëskryetari zgjidhet pa debat, me shumicë votash dhe kur janë të pranishëm $\frac{3}{4}$ e anëtarëve. Mënyra e votimit dakordësohet paraprakisht nga anëtarët e Komisionit.
- 4. Në rast se kandidati i propozuar nuk merr shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, atëherë Kryetari propozon një kandidaturë të dytë, me të njëjtat kritere, e cila votohet në mbledhjen e radhës.
- 5. Nëse rezultati i votimit është i barabartë, atëherë votimi përsëritet dhe, nëse përsëri rezultati i votimit është i barabartë, atëherë vendos vota e Kryetarit.
- 6. Anëtari i propozuar për Zëvendëskryetar rezervon të drejtën e refuzimit të kandidaturës në çdo moment, deri në fillimin e procesit të votimit.

Neni 9

Lirimi dhe shkarkimi nga detyra e Zëvendëskryetarit

- 1. Zëvendëskryetari lirohet nga Komisioni:
 - a) me kërkesën e tij;
 - b) nëse largohet nga institucioni që përfaqëson në Komision ose nëse kalon në një detyrë tjetër;
 - c) nëse titullari i institucionit që përfaqëson e zëvendëson me një anëtar tjetër.
- 2. Zëvendëskryetari shkarkohet nga Komisioni kur:
 - a) konstatohen shkelje të etikës profesionale gjatë kohës që ushtron veprimtarinë në Komision;

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

b) ndaj ti merret masë administrative “shkelje e rëndë” sipas legjislacionit për nëpunësin civil ose masë të kësaj natyre kur Zëvendëskryetari nuk është pjesë e shërbimit civil;

c) për shkaqe sëmundje, gjë që e bën të paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara për më shumë se 3 muaj;

ç) nuk merr pjesë në mbledhje të paktën 3 herë radhazi.

3. Zëvendëskryetari mund të zëvendësohet nga Komisioni me propozimin me shkrim nga të paktën një anëtar i tij. Propozimi për shkarkim duhet të përmbajë arsyetimin, shkaqet dhe rrethanat e shkarkimit, dokumente shkresore mbi të cilën mbështetet propozimi si dhe duhet të depozitohet në Sekretariatit e Komisionit jo më vonë se 5 ditë nga data e zhvillimit të mbledhjes.

4. Sekretariati e protokollon menjëherë propozimin për zëvendësim sipas pikës 3 të këtij neni dhe, nëpërmjet Kryetarit, njofton menjëherë anëtarët e Komisionit. Kryetari thërret mbledhjen e jashtëzakonshme të Komisionit brenda 5 (pesë) ditëve për shqyrtimin e propozimit.

5. Votimi për zëvendësimin e Zëvendëskryetarit bëhet me shumicë të thjeshtë dhe votim të fshehtë, në praninë e $\frac{3}{4}$ të të gjithë anëtarëve.

Neni 10

Caktimi dhe lirimi i anëtarit të Komisionit

1. Anëtar i përfaqëson institucionin publik përkatës në Komision.

2. Anëtar i caktohet nga titullari i institucioneve përkatëse sipas kërkesës së INSTAT dhe këtyre kriterëve:

a) të jetë të paktën në pozicionin e nivelit të ulët drejtues sipas hierarkisë së përcaktuar nga legjislacioni për nëpunësin civil, ose pozicion të ngjashëm për nëpunësit e tjerë;

b) të jetë përdorues i nomenklaturave dhe klasifikimeve për shkak të detyrës që mbulon në institucion;

c) të jetë i autorizuar të marrë vendime në emër të institucionit, si anëtar në Komision.

4. Anëtar i humbet të drejtën e përfaqësimit në Komision kur:

a) titullari i institucionit që përfaqëson cakton një person tjetër;

b) largohet nga institucioni që përfaqëson ose kalon në një detyrë tjetër;

c) konstatohen shkelje të etikës profesionale gjatë kohës që ushtron veprimtarinë në Komision;

ç) ndaj tij është marrë masë administrative “shkelje e rëndë” sipas legjislacionit për nëpunësin civil ose masë e kësaj natyre kur anëtar i nuk është pjesë e shërbimit civil;

d) për shkaqe sëmundje, është i paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara për më shumë se 3 muaj;

dh) nuk merr pjesë në mbledhje të paktën 3 herë radhazi.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

5. Nëse konstatohet një nga rastet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni, Kryetari i dërgon njoftim shkresor titullarit të institucionit përkatës për zëvendësimin me një anëtar tjetër sipas kritereve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni.

Neni 11

Kompetencat e anëtarëve

1. Anëtarët e Komisionit japin kontributin e tyre në të gjitha fazat e përgatitjes së nomenklaturës, sipas përgjegjësisë.
2. Në rast se shikohet e arsyeshme, anëtarët kanë të drejtën të asistohen nga ekspertë të tjerë të institucionit që përfaqësojnë, por pa të drejtë vote.
3. Anëtari mund të ngarkohet me detyra dhe përgjegjësi nga Komisioni, për të ndjekur apo udhëhequr një proces të caktuar në lidhje me përshtatjen e nomenklaturës. Anëtari përgjegjës bashkëpunon ngushtësisht me Sekretariatën për përgatitjen e dokumentacionit të mbledhjes në lidhje me nomenklaturën në përgjegjësi të tij.
4. Anëtari i raporton Komisionit ecurinë e zbatimit të nomenklaturës dhe propozon zgjidhje në rast të problemeve të hasura në praktikë.
5. Çdo anëtar është i detyruar të mbajë të përditësuar Sekretariatën në lidhje me referencat e kontaktit:
 - a) nr.telefoni;
 - b) adresë e-mail.

Neni 12

Sekretariati

1. Sekretariati është strukturë e ngritur në mbështetje të pikës 4 të VKM nr. 671, datë 7.11.2018 “Për ngritjen, funksionimin dhe detyrat e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën”.
2. Sekretariati përbëhet nga 2 (dy) specialistë të INSTAT-it, të cilët caktohen me urdhër të veçantë të drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT-it.
3. Sekretariati i prezantohet Komisionit nga Kryetari në mbledhjen e radhës së Komisionit.
4. Përbërja e Sekretariatit rishikohet nga Kryetari nëse kërkohet nga anëtarët e Komisionit për arsye të konfliktit të interesit.
5. Komisioni cakton një anëtar të tij me detyrën për mbikëqyrjen e punës së sekretariatit.

Neni 13

Detyrat e Sekretariatit

1. Sekretariati ka për detyrë:

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

a) të mbajë korrespondencën shkresore ndërmjet anëtarëve të Komisionit lidhur me shkëmbimin e mendimeve dhe propozimeve për çështjet në diskutim;

b) të përgatisë dokumentacionin e mbledhjeve dhe t'ia vëjë në dispozicion anëtarëve të Komisionit sipas rendit të ditës;

c) të lehtësojë organizimin e mbledhjeve duke marrë masa për sigurimin e ambientit, logjistikës dhe infrastrukturës online;

ç) të mbajë rekordet mbi prezencën e anëtarëve;

d) të mbajë minutat e takimit dhe, pas dakordësimit të minutave nga anëtarët, të hartojë procesverbalin përkatës të mbledhjes.

2. Për të ushtruar detyrën e përcaktuar në shkronjën (c) të pikës 1 të këtij neni, Sekretariati ka të drejtë të kërkojë ndihmën e stafit mbështetës IT të INSTAT-it dhe institucioneve të përfaqësuara në Komision.

KREU III

MBLEDHJET E KOMISIONIT DHE MARRJA E VENDIMEVE

Neni 14

Mbledhjet e Komisionit

1. Mbledhjet e Komisionit zhvillohen në përputhje me nenin 4 e vijues të Ligjit nr.8480, datë 25.08.1999.

2. Komisioni mblidhet jo më pak se 3 (tre) herë në vit dhe sa herë është e nevojshme për raste që lidhen me çështjet e parashikuara në pikën 3 të nenit 4 të kësaj rregullore.

3. Mbledhja e Komisionit thirret nga Kryetari.

4. Në raste të jashtëzakonshme, Komisioni mund të mblidhet me propozim të 2 (dy) apo më shumë anëtarëve, pas dakordësimit nga Kryetari i Komisionit.

5. Kryetari vendos për rendin e ditës, datën, kohën dhe vendin e mbledhjes së radhës dhe, nëpërmjet Sekretariatit, njofton me shkrim dhe në formë elektronike anëtarët e Komisionit jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së thirrjes së mbledhjes.

6. Njoftimi i mbledhjes nënshkruhet nga Kryetari, sekretohet në protokollin e INSTAT-it dhe përmban të paktën:

a) agjendën e mbledhjes;

b) vendin, datën dhe orën e takimit;

c) emrin e anëtarit iniciues të mbledhjes;

ç) referencat për materialet dhe dokumentacionet që do të shqyrtohen.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

7. Si rregull, mbledhja e Komisionit zhvillohet në ambientet e INSTAT, me përjashtim të rastit kur Kryetari vendos ndryshe.

8. Në raste të veçanta, mbledhjet zhvillohen online në një nga platformat e organizimit të mbledhjeve online, e cila i komunikohet anëtarëve të Komisionit nga Sekretariati përpara zhvillimit të mbledhjes.

9. Data e njoftimit elektronik për mbledhje do të konsiderohet data e dërgimit të lajmërimit në rrugë elektronike në adresën e anëtarit. Si rregull, anëtari i Komisionit dërgon konfirmimin paraprak për pjesëmarrje *on-line* ose fizikisht.

10. Në rastet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni, mund të mos ndiqen afatet e mësipërme mbi njoftimin e mbledhjes. Megjithatë, përmbajtja e njoftimit të mbledhjes duhet të jetë sipas parashikimit në pikën 6 të këtij neni.

11. Mbledhja e Komisionit drejtohet nga Kryetari dhe, në mungesë të tij, nga Zëvendëskryetari dhe është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se $\frac{1}{2}$ e anëtarëve.

12. Përpara fillimit të mbledhjes, Sekretariati vërteton prezencën e anëtarëve të Komisionit, nëpërmjet një listëprezence të nënshkruar nga anëtarët e Komisionit të pranishëm në sallën e mbledhjes. Në rastet kur anëtarët ose një pjesë e tyre janë të pranishëm *on-line*, atëherë listëprezenca për këta anëtarë nënshkruhet nga Sekretariati, duke reflektuar përbri çdo emri të anëtarit fjalën “*on-line*”.

13. Nëse konstatohet se në mbledhje janë të pranishëm më pak se $\frac{1}{2}$ e numrit të anëtarëve të Komisionit, atëherë drejtuesi vendos të shtyjë mbledhjen në një ditë tjetër, e cila duhet të zhvillohet jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë.

14. Mbledhja e Komisionit është e vlefshme edhe kur nuk respektohen procedurat e parashikuara për thirrjen dhe zhvillimin e saj, vetëm në rast se në atë mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët me të drejtë vote, të cilët, paraprakisht, miratojnë agjendën dhe zhvillimin e mbledhjes.

Neni 15

Materialet e mbledhjes dhe mënyra e paraqitjes së tyre për shqyrtim

1. Materialet për shqyrtim në mbledhjen e Komisionit sipas rendit të ditës, depozitohen pranë Sekretariatit, i cili ia shpërndan anëtarëve jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e zhvillimit të mbledhjes.

2. Në rastet kur materialet e paraqitura konsiderohen si jo të plota nga Kryetari ose anëtari i ngarkuar nga Komisioni për mbikëqyrjen e Sekretariatit, sipas pikës 5 të nenit 12 të kësaj rregulloreje, atëherë Sekretariati ia rikthen për shqyrtim strukturave përgjegjëse të cilat e kanë përgatitur atë.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

3. Strukturat përgjegjëse rishqyrtojnë materialet dhe ia ridërgojnë Sekretariatit brenda tre ditëve.

4. Sekretariati merr masa që të ruhen në një dosje të veçantë relacionet me shkrim të anëtarëve, procesverbali i mbledhjes dhe vendimet që merr Komisioni. Dokumentacioni i secilës mbledhje depozitohet në arkivë/protokollin e INSTAT-it.

Neni 16

Procedura e marrjes së vendimeve dhe e votimit në mbledhjet e Komisionit

1. Komisioni i merr vendimet në mënyrë kolegjiale me votim të hapur.
2. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe që kanë të drejtën e votës.
3. Secili anëtar i Komisionit ka të drejtën e një vote.
4. Kryetari voton i fundit.
5. Në votim nuk lejohet abstenimi. Vota kundër argumentohet dhe pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes.
6. Në rastin kur rezultati i votimit të hapur është i barabartë, atëherë procedura e votimit përsëritet edhe një herë. Në rast se votimi rezulton përsëri i barabartë, atëherë vota e Kryetarit është vendimtare.
7. Në rastet kur ndaj materialit të paraqitur bëhen vërejtje, atëherë Komisioni i voton atë në parim dhe, nëse votohet pro në parim, atëherë kalohet në votimin e çdo propozimi të bërë nga secili anëtar dhe, në fund, vendoset për materialin në tërësi me ndryshimet e bëra në mbledhje. Në të kundërt, materiali nuk miratohet dhe ndiqet procedura e parashikuar në pikën 4 të nenit 19 të kësaj rregulloreje.
8. Vendimet e Komisionit nënshkruhen nga Kryetari dhe Sekretariati i Komisionit. Zëvendëskryetari nënshkruan në mungesë të Kryetarit.
9. Nëse gjykohet e arsyeshme nga Komisioni, INSTAT publikon vendimet e Komisionit në faqen elektronike zyrtare të tij.

Neni 17

Procesverbali i mbledhjes

1. Në çdo mbledhje të Komisionit, mbahet një procesverbal i cili përmban të paktën një përmbledhje diskutimeve të zhvilluara, datën dhe vendin e mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën si dhe formën dhe rezultatin e votimeve.
2. Procesverbali hartohet nga Sekretariati dhe i dërgohet brenda 3 (tre) ditëve për miratim në rrugë elektronike secilit anëtar që ka marrë pjesë në mbledhje. Nëse nuk ka

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

kundërshtime nga anëtarët, atëherë procesverbali i mbledhjes zbardhet dhe nënshkruhet nga Kryetari dhe të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje, në të gjitha faqet e tij.

3. Në rastet kur mbledhja është zhvilluar gjatë një periudhe më shumë se një ditore, atëherë procesverbali paraqet në formë të përmbledhur diskutimet e zhvilluara gjatë secilës dite.

4. Në procesverbal shënohen edhe argumentet e anëtarëve që kanë votuar kundër vendimit të miratuar.

KREU IV
PËRSHTATJA E NOMENKLATURËS

Neni 18

Propozimi për përshtatjen e nomenklaturave

1. Çdo institucion i përfaqësuar në Komision ka të drejtën e paraqitjes së kërkesës ose propozimit për përshtatjen e një nomenklature të caktuar ndërkombëtare, për qëllime statistikore.

2. Propozimi për përshtatjen dhe zbatimin e nomenklaturës, i paraqitet me shkrim në çdo kohë kryetarit të Komisionit nga anëtari përfaqësues i institucionit në Komisionit. Propozimi përmban të paktën:

- a) aktin ndërkombëtar mbi të cilën bazohet aplikimi i nomenklaturës;
- b) nomenklaturën e përkthyer në gjuhën shqipe;
- c) relacionin shpjegues i cili, nga ana e tij, duhet të përmbajë:
 - i) Qëllimin e nomenklaturës dhe objektivat që synohen të arrihen;
 - ii) Vlerësimin e nomenklaturës në raport me politikat e zhvillimit të statistikave zyrtare apo programet e qeverisjes;
 - iii) Përparësitë që do të sjellë përafrimi i nomenklaturës dhe efektet e pritshme;
 - iv) shkallën e përafrimit me aktin ndërkombëtar;
 - v) përmbledhjen shpjeguese;
 - vi) impaktin financiar.
- ç) institucionin përgjegjës për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të nomenklaturës.

3. Kryetari i Komisionit, ia përcjell dokumentacionin Sekretariatit për përgatitjen e dokumentacionit në mbledhjen e radhës. Sekretariati i Komisionit ia përcjell për shqyrtim anëtarëve të Komisionit brenda 3 (tre) ditëve.

4. Anëtari i institucionit propozues relaton përshtatjen e nomenklaturës në mbledhjen e Komisionit dhe mbështet INSTAT në hapat e mëtejshëm për procedurat e miratimit në Këshillin e Ministrave.

Neni 19

Shqyrtimi i propozimeve

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

1. Çdo anëtar i Komisionit ka të drejtën e shqyrtimit të dokumentacionit për propozimin dhe përshtatjen e nomenklaturës.

2. Përpara se Projekt-nomenklatura e propozuar të miratohet si e tillë nga Komisioni, anëtari i institucionit propozues merr masa që materiali të jetë i përkthyer zyrtarisht në gjuhën shqipe. Gjatë shqyrtimit të projekt-nomenklaturës, Komisioni ka të drejtë të japë komente edhe për përkthimin e materialit me qëllim që të arrihet përshtatja e duhur nga ana teknike.

3. Anëtarët e Komisionit dërgojnë komentet dhe propozimet për nomenklaturën brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dorëzimi i materialeve sipas pikës 3 të nenit 18 të kësaj rregullore. Kryetari, brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i afatit për paraqitjen e komenteve, thërret mbledhjen e Komisionit duke përfshirë në rend dite diskutimet për nomenklaturën e propozuar.

4. Nëse anëtarët e Komisionit gjykojnë gjatë mbledhjes se projekt-nomenklatura ka mangësi apo nevojë për përpunim të mëtejshëm, atëherë Komisioni vendos kthimin e projekt-nomenklaturës tek institucioni propozues për shqyrtimin dhe rregullimin e mangësive brenda 30 (tridhjetë) ditëve.

5. Në rast se anëtarët e Komisionit gjykojnë se projekt-nomenklatura nuk ka nevojë për përpunim të mëtejshëm, atëherë ajo miratohet në parim me votim të hapur dhe i kalohet INSTAT-it për përgatitjen e praktikës së duhur për propozim në Këshillin e Ministrave.

6. Komisioni mund të ngrejë grupe pune, sipas fushave dhe nevojave të tij, me përbërje nga të gjithë institucionet e përfshira në Komision ose një pjesë e tyre. Rregullat për funksionimin e këtyre grupeve dhe shkallën e përgjegjësisë së tyre, përcaktohen me vendim të veçantë të këtij komisioni.

Neni 20

Miratimi i Projekt-nomenklaturës

1. Komisioni miraton me vendim të veçantë projekt-nomenklaturën dhe dokumentacionin shoqërues sipas nenit 16 të kësaj rregulloreje dhe ia përcjell INSTAT-it për përgatitjen e praktikës së nevojshme për miratimin e projekt-nomenklaturës në Këshillin e Ministrave.

2. Në vendimin sipas pikës 1 të këtij neni, Komisioni cakton edhe institucionin përgjegjës për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të nomenklaturës.

3. Vendimi për miratimin e projekt-nomenklaturës merret në përputhje me përcaktimet e nenit 16 të kësaj rregulloreje.

4. Komisioni ngarkon INSTAT-in të dërgojë projekt-nomenklaturën për miratim në Këshillin e Ministrave, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e vendimit të Komisionit.

Neni 21

Monitorimi i zbatimit të nomenklaturës dhe forma e raportimit

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

1. Komisioni ka të drejtën e monitorimit dhe raportimit mbi nivelin e zbatimit të nomenklaturës së hyrë në fuqi me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave. Këtë të drejtë Komisioni e ushtron duke ia paraqitur kërkesën për raportim anëtarit përgjegjës, në mbledhje.

2. Anëtari përfaqësues i institucioni përgjegjës për monitorimin, i caktuar sipas pikës 2 të nenit 20 të kësaj rregulloreje, i paraqet Komisionit raporte mbi nivelin e zbatimit të nomenklaturës, problemet e ndeshura dhe, sipas rastit, propozimet për zgjidhjet e mundshme.

3. Raporti i monitorimit përgatitet dhe i dërgohet Kryetarit të Komisionit brenda 45 ditëve nga kërkesa e Komisionit për përgatitjen e raportit. Kryetari ia përcjell raportin anëtarëve të Komisionit nëpërmjet Sekretariatit të Komisionit dhe e përfshin për diskutim në rendin e ditës të mbledhjes së radhës.

4. Përmbajtja dhe forma e raportimit caktohet nga Komisioni dhe është e njëjtë për të gjitha nomenklaturat.

KREU V
TË TJERA

Neni 22
Shfuqizime

Rregullorja “Për funksionimin e Komisionit Kombëtar për përshtatjen dhe zbatimin e Nomenklaturave” Nr.425/19 Prot., datë 03.10.2018, shfuqizohet.

Neni 23
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të INSTAT.

KOMISIONI KOMBËTAR PËR NOMENKLATURËN

KRYETARI
ELSA DHULI

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al